REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.210/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Franciska Zhitija Ymeri, kryetare e kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Faton Bajrami, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit NTP "Besa Trade" me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson F.H., avokat, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.565/18 të datës 19.05.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 08.12.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit, NTP "Besa Trade" me seli në Prishtinë ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.565/18 të datës 19.05.2020, **vërtetohet.**

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, me aktvendimin, A.nr.565/18 të datës 19.05.2020, e ka hedhë poshtë kërkesën e paditësit NTP "Besa Trade" me seli në Prishtinë, të ushtruar në Gjykatë me datën 26.02.2020, për vazhdimin e procesit gjyqësor, të pezulluar me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal A.nr.565/18 i datës 06.02.2020, si të palejueshme.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka parashtruar ankesë paditësi, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës lidhur me konfliktin administrativ dhe për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Me propozim që Dhomat e Shkallës së dytë këtë çështje ta kthen ën rivendosje në gjykatën e shkallës së parë apo të vendos vet në bazë të kompetencave të veta.

Përgjigje në ankesë nga e paditura nuk ka.

Gjykata Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA, nenit 81.H të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja me datë 02.02.2020 ka ushtruar ankesë në Bordin e Pavarur për Rishqyrtime kundër vendimit të ATK-së nr.471/2009 datë 05.01.2020, bordi i Pavarur për Rishqyrtime me Aktvendimin A.nr. 12/2110-ATK datë 29.04.2013 ka anuluar vendimin e Departamentit të Ankesave nr. 471/2009 të datës 05.01.2010. ATK ka paraqitur padi në gjykatë ndaj vendimit të BPR-së nr.12/2110-ATK datë 29.04.2013. Gjykata e Apelit me Aktgjykimin AA.nr.169/2013 të datës 14.03.2018 ka aprovuar padinë e ATK dhe ka anuluar vendimin e BPR-së A.nr.12/2110-ATK datë 29.04.2013 dhe çështjen e ka kthyer në rivendosje në Gjykatën Themelore në Divizion Fiskal.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas aktgjykimit AA.nr. 169/2013 të datës 14.03.2018, me datë 06.02.2020, ka mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor në të cilën kanë prezantuar përfaqësuesi i autorizuar i paditësit dhe përfaqësuesja e autorizuar e palës së paditur. Pas shqyrtimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse bie aktvendim për pezullimin e procedurës në këtë konflikt administrativ sipas padisë së paditësit, për shkak të heqjes dorë nga padia të palës paditëse.

Pas aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë A.nr.565/18 të datës 06.02.2020 paditësi me datë 26.02.2020 ka paraqitur pranë gjykatës kërkesë për vazhdimin e procesit gjyqësor me nr. Anr.565/18. Gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqyrtimit të kërkesës së palës paditëse, e ka

hedhë poshtë padinë në këtë çështje juridiko administrative si të pa lejuar. Gjykata ka vlerësuar se nuk mund të vazhdohet procedura në këtë konflikt administrativ, pasi që kjo procedurë tani për tani ka përfunduar me nxjerrjen e vendimit të gjykatës, dhe me asnjë dispozitë ligjore të konfliktit

administrativ nuk parashihet e drejta që pala e cila ka hequr dorë nga padia, mund të kërkoj nga gjykata sërish vazhdimin e procedurës gjyqësore e cila ka përfunduar me nxjerrjen e vendimit për pezullim të procedurës. Andaj, gjykata ka vlerësuar se kërkesa e paditësit për vazhdimin e procedurës gjyqësore është e palejueshme, prandaj për këto arsye në bazë të nenit 81.C të Ligjit nr. 04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, si dhe neneve 4, 9, 23, 31, 34, 45, 47, 49, 52 të Ligjit nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Dhoma e Shkallës së Dytë vlerësoi bazuar në këto dispozita ligjore të lartcekura, Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, me të drejtë e ka hedhë poshtë padinë e paditësit në këtë çështje juridiko-administrative si të palejuar, ngase në këtë çështje juridike nuk janë plotësuar kushtet për vazhdimin e procedurës gjyqësore, meqë kjo çështje ka përfunduar me nxjerrjen e vendimit për pezullim të procedurës. Andaj, pretendimet ankimore të paditësit se aktvendimi i ankimuar është përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës lidhur me konfliktin administrativ, sikur që gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht dhe në mënyrë të drejtë. Kolegji i kësaj gjykate këto pretendime ankimore i konsideron si të pa bazuara dhe pa ndikim, meqë gjykata e shkallës së parë me të drejtë i është referuar Ligjit nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative përkatësisht nenit 31 paragrafi 1 kur ka pezulluar procedurën me vendim. Prandaj, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate aktvendimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Andaj, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktvendimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, vlerëson të drejtë këtë qëndrim juridik të dhënë në aktvendimin e ankimuar, për faktin se vendimi është marrë duke respektuar dispozitat ligjore dhe procedurale të parapara me Ligjin për Konfliktet Administrative.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.210/22, me datë 08.12.2023

Kryetare e kolegjit,

Franciska Zhitija Ymeri